

Komiteti Këshillëdhënës i Pagesave Ndërbankare (KKPN)

Me qëllim të organizimit, udhëheqjes dhe koordinimit të punëve në kuadër të sistemit të pagesave ndërbankare u formua edhe **Komiteti Këshillëdhënës i Pagesave Ndërbankare (KKPN)**. Ky komitet fillimisht është themeluar më qëllim të shqyrtimit të të gjitha rregullave dhe procedurave¹ të Sistemit të Kliringut Ndërbankar dhe Shlyerjeve Në mënyrë që pastaj të arrihen marrëveshje paraprake për të gjitha çështjet e pagesave dhe veprimet tjera procedurale. Në bashkëpunim të afërt me bankat pjesëmarrëse përmes KKPN u bë e mundur që të zhvillohen të gjitha procedurat operative ditore të SNP-së si dhe të shqyrtohen shumë çështje bazike për zhvillim dhe funksionim të këtij sistemi, duke filluar nga:

- **Rregullat dhe Procedurat e punës të sistemit të kliringut dhe shlyerjeve**
- **Forma standarde e urdhër pagesës dedikuar për pagesa të vendit**
- **Struktura e tarifave dhe provizioneve të SKN (analizime dhe propozime)**
- **Shqyrtimi dhe përshtatja e sistemit të numrave standard të llogarive bankare të bazuara në IBAN (procedurat dhe standardet)**
- **Çështjet tjera në lidhje me krijimin e standardeve të procedurave ditore (mbi menaxhimin e riskut operacional, sistematik dhe legal)**
- **Diskutime dhe analiza të ndryshme mbi zhvillimet, të arriturat dhe objektivat**
- **Diskutime dhe analiza mbi veprimet në raste të jashtëzakonshme dhe krijimi i procedurave**
- **Plotësime të procedurave ekzistuese dhe formulime standarde të formave të raportimit për të gjitha format e pagesave në Kosovë**
- **Arritjen e formës standarde të raportimit tremujor të bankave për të gjitha mënyrat e pagesave vendase, instrumenteve të pagesave, pagesave përmes ATM, POS, e-banking etj (me marrëveshje).**
- **Diskutime dhe analiza për planifikimin e projekteve të reja në kuadër të SNP**

Roli kryesor i këtij Komiteti këshillues qëndron në shqyrtimin e politikave operative dhe funksionale të sistemit të pagesave ndërbankare Duke shërbyer njëkohësisht si urë lidhëse ndërmjet BQK-së dhe bankave komerciale për përsosje të politikave ekzistuese dhe krijim të strategjive të reja të zhvillimit të sistemit të kliringut.

Komiteti në fjalë ka karakter të punës këshilluese ku të gjithë përfaqësuesit japin mendimet, vërejtjet e sugjerimet. Takimet e këtij këshilli mbahen një herë në muaj apo edhe më shpesh atëherë kur kërkohet jo vetëm nga organizatori dhe udhëheqësi i këtyre takimeve (menaxheri i SKN në BQK) por edhe nga anëtarësia e pjesëmarrëse në sistem. Anëtarë të Komitetit Këshillëdhënës të Pagesave Ndërbankare janë zyrtarët kryesor të pagesave dhe operimeve nga të gjitha bankat komerciale dhe një përfaqësues i pagesave nga MEF (ka marrë pjesë në këtë këshillë) sipas nevojës; është kërkesë të jetë anëtarë i përhershëm)

Një marrëveshje e arritur me bankat mbi detyrat dhe përgjegjësitë² e bankës dhe përfaqësuesve zyrtar kontakt në SKN është dhënë përmes kësaj forme standarde të letër mirëkuptimi e cila azhurnohet sipas ndryshimeve **të paraqitura në nivele të caktuara përfaqësuesish.**

¹ Në shumë vende ekziston një trupë e ngjajshme e themeluar posaçërisht për çështje pagesash në nivel kombëtar, duke përfshirë bankën qendrore, bankat komerciale dhe ndonjë institucion tjetër që aktivisht merr pjesë në sistem të pagesave. Me një ekzistim të tillë të një trupe koordinuese apo këshille të përbashkët mund të diskutohen lirisht idetë, informatat dhe kërkesat për të gjitha shërbimet e pagesave të përdorshme, instrumenteve e dhe mënyrave të reja të pagesave. Me të njëjtin qëllim u formua edhe në kuadër të BQK ky komitet.

² *përveç plotësimit të fletë-aplikacionit fillestar të dhënë tek rregullat dhe procedurat e SKN, i cili plotësohet vetëm kur antarësohet një bankë në SKN.*

LETËR MIRKUPTIMI

(për të gjitha bankat anëtare të SEKN-së, i cili është i organizuar dhe i mbikëqyrë nga BQK)

1. BANKA

Është e njohur me rregulloren për transaksione të pagesave pastaj me rregulloren dhe procedurat e punës së Sistemit të Pagesave Ndërbankare (ICS). Banka jonë ka pranuar që të jetë pjesëmarrëse në sistem të pagesave dhe njëkohësisht do të marrim pjesë në punën e komitetit këshillëdhënës të pagesave.

2. Është njohur me të rregullat dhe procedurat ekzistuese si dhe me detyrat dhe përgjegjësitë për pjesëmarrje në sistem të kliringut.

3. Është e njohur me përdorimin e urdhërpagesës si instrument të vetëm të shfrytëzuar në qarkullimin e pagesave të vendit dhe me formë standarde të pranuar nga të gjithë pjesëmarrësit.

4. Është njohur me marrëveshjen mbi zhvillim të sistemit të kliringut ndërbankar të mënyrës elektronike, SEKN dhe në rast të pengesave eventuale transaksionet bankare të kryhen në çfarëdo mënyre tjetër apo të zhvillohet seancë kliringu dhe të bëhet këmbimi i urdhërpagesave dhe të rregullohen rezultatet e kliringut në baza të neto debisë apo kredisë se bankës gjatë asaj dite punuese.

5. Banka njofton për emrat e zyrtarëve të saj në kliring (nën 1 dhe 2)) me të cilët mund të zhvillon kontakte BQK (SKN) në kuadër të operativës ditore d.t.th. për mbarëvajtje operacionale dhe koordinim të punëve teknike, zgjedhje dhe realizim me kohë të të gjitha transaksioneve të pagesave brenda dite.

1. _____
zyrtari i operimeve në sistemin e kliringut dhe të pagesave pran bankës

2. _____
zyrtari IT në sistemin e kliringut dhe të pagesave pran bankës

6. Banka njofton për përfaqësuesin e saj në Komitetin Këshillëdhënës të Pagesave Ndërbankare (IPAC). i cili do të punon në zhvillimin e politikave rregullative të këtij sistemi. i cili preferohet të caktohet nga **Menaxhmenti i Bankës** dhe mundësisht të jetë profesionalist në këtë lëmi. Me qëllim që të organizojmë, punojmë dhe koordinojmë në marrëveshje sistemin e pagesave me synim për përsosje dhe zhvillime të mëtejme.

1. _____; Pozita _____
zëvendës i personit nën 1

2. _____; Pozita _____

7. Në rast të mospjesëmarrjes në takimet e komitetit KKPN banka me shkrim duhet të njoftoi udhëheqësin e këtij komiteti këshillëdhënës të BQK-së (e që njëkohësisht është edhe Drejtori i Sistemit të Pagesave Ndërbankare në BQK)

Vula dhe nënshkrimi i personit të autorizuar

[Bankat pjesëmarrëse në Sistem të Kliringut Ndërbankar të BQK-së](#)

Banka Ekonomike

Rr. Migjeni 1,
10000 Prishtinë
tel.381 (0) 38 225 353
fax.381 (0) 38 225 454
<http://www.bekonomike.com>
info@bekonomike.com

- 1.
 - 2.
-

Banka për Biznes

Rr. UCK, Nr. 41, Prishtinë
10000 Prishtinë
tel.381 (0) 38 244 666
fax.381 (0) 38 243 656, 657
<http://www.bpbbank.com>
info@bpbbank.com

- 1.
 - 2.
-

ProCredit Banka

Rr.Nëna Terezë no.16
10000 Prishtine
tel.381 (0) 38 555 777
fax.381 (0) 38 248 777
<http://www.procreditbank-kos.com>
info@procreditbank-kos.com

- 1.
 - 2.
-

Banka Raiffeisen e Kosovës

Rr. UÇK Nr. 51,
10000 Prishtine
tel.381 (0) 38 22 22 22 142
fax.381 (0) 38 20 30 11 30
<http://www.raiffeisen-kosovo.com>
info@raiffeisen-kosovo.com

- 1.
 - 2.
-

Banka Kombëtare Tregtare

Dega Kosovë
Qyteza Pejton, Rr. Kosta Novakoviç Nr.9
10000 Prishtinë
tel.381 (0) 38 222 910
fax.381 (0) 38 222 907
<http://www.bkt.com.al>
infoBktKosova@bkt.com.al

- 1.

2.

TEB Banka

Rr. Agim Ramadani 15
10000 Prishtinë
tel.381 (0) 38 230 000
fax. 381 (0) 38 224 699
<http://www.teb-kos.com>
info@teb-kos.com

1.

2.

NLB Prishtina

Rr. Rexhep Luci nr.5
10000 Prishtinë
tel.381 (0) 38 234 111
fax. 381 (0) 38 246 189
<http://www.nlbprishtina-kos.com>
info@nlbprishtina-kos.com

1.

2.
